



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

KATALOG

i botimeve të Universitetit të Prishtinës
"Hasan Prishtina"
2022-2023

Prishtinë, 2023



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

KATALOG

i botimeve të Universitetit të Prishtinës
"Hasan Prishtina"
2022-2023

Prishtinë, 2023



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Adresa:

Rr. "George Bush", Nr. 31, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës

Tel:

+383 38 244 183/244 186

Email:

rektorati@uni-pr.edu

1970 · MCMLXX



KATALOG

i botimeve të Universitetit të Prishtinës
"Hasan Prishtina"
2022-2023

KATALOG

i botimeve të Universitetit të Prishtinës
"Hasan Prishtina"
2022-2023



Botimet e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" prezantohen në edicionin e dytë të PANAIRIT MBARËKOMBËTAR TË LIBRITAKADEMIK DHE SHKENCOR me publikimet e realizuara përgjatë periudhës prill 2022–prill 2023.

Ky katalog, përveç të dhënave standarde, ofron edhe informata për përmbajtjen dhe rëndësinë që kanë këto tekste në shkencat respektive, tekste të cilat, këtë radhë, janë të identifikueshme edhe vizualisht, duke qenë se Këshilli Botues tashmë ka aprovuar një dizajn unik të ballinës së publikimeve universitare të UP-së.

Në këtë panair, që organizohet nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit – Tiranë, Universiteti i Prishtinës paraqitet për të konfirmuar traditën e konsoliduar dhe cilësinë e lartë të angazhimit të mësimdhënësve dhe hulumtuesve të vet për studime të thelluara dhe avancimin e dijes dhe, më pas, komunikimin e gjetjeve përmes teksteve shkencore e universitare, praktikumeve, monografive, etj.

Në këtë proces, Këshilli Botues është mandatar për përkrahje, për sigurim të cilësisë dhe për të ofruar perspektivën për të ecur me trendin ndërkombëtar të botimeve akademike dhe shkencore.

Këshilli Botues i Universitetit të Prishtinës



HOTI, RAMIZ

Kumarina dhe derivatet e saj : (sinteza dhe aktiviteti biologjik i tyre) /

Ramiz Hoti. - Prishtinë:

Universiteti i Prishtinës, 2022. - 102 f : ilustr. ; 24 cm.

Kimia – Kimia organike -- Kimia farmaceutike

ISBN 978-9951-00-313-1

Ky tekst është lejuar për botim dhe përdorim për nevoja universitare me vendim të Këshillit Botues të UP-së, pas pëlqimit nga njësia akademike dhe vlerësimit të recensentëve, të cilët kanë konstatuar se kjo monografi është hartuar duke pasur për bazë standarde të larta shkencore, profesionale, metodike e didaktike. Rrjedhimisht, ky tekst është burim i vlefshëm për përdorim të gjerë nga studiuesit që merren me hulumtime nga kimia organike sintetike, me fokus në derivatet e kumarinës.



DAUTAJ, ARTON D.

Mekanika e materialeve 1/Arton D. Dautaj. - Prishtinë:
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2022.– 617 f. : ilustr. ; 24 cm.
Inxhinieria mekanike
Mekanika – Problema, ushtrime etj. – Tekste universitare
ISBN 978-9951-00-317-9

Ky tekst është lejuar për botim dhe përdorim si tekst universitar me vendim të Këshillit Botues të UP-së, duke u mbështetur në vlerësimin e lartë të recensentëve, të cilët ia atribuojnë autorit meritën për kalimin në mënyrë të veçantë nga projektimi sipas sforcimeve të lejuar në projektimin sipas gjendjes kufitare. Teksti i ndërtuar në katërmëdhjetë kapituj dhe gjashtë shtojca, i mbështetur në një metodologji të qëlluar në aspektin profesional, didaktik dhe pedagogjik, është një kontribut i çmuar sidomos për fushën e inxhinierisë së ndërtimit, por edhe inxhinierisë mekanike e të ngjashme, ku mungojnë tekste të tilla.



KËPUSKA, ARBNORE BATALLI

Reumatologjia pediatrike / Arbnore Batalli Këpuska, Lidvana Spahiu. - Prishtinë: Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2023. - 149 f. : ilustr. ; 24 cm.


1.Spahiu, Lidvana

Mjekësia – Pediatria – Reumatologjia të fëmijët

ISBN 978-9951-00329-2

Ky tekst është lejuar për botim dhe përdorim për nevoja universitare me vendim të Këshillit Botues të UP-së dhe paraqet një nga tekstet e rralla në gjuhën shqipe sa i përket trajtimit teorik dhe praktik të këtij aspekti të reumatologjisë.

Duke qenë i tillë, recensentët kanë vlerësuar se ky tekst do të jetë ndihmë e madhe, jo vetëm për studentët e shkencave mjekësore, por për tërë komunitetin e profesionistëve mjekësorë pediatrikë në vendin tonë.



BEXHETI, SADI

Anatomia e njeriut : gjymtyra e sipërme dhe e poshtme = membrum superius et inferius/Sadi Bexheti, Selim Çerkezi, Jeton Shatri. - Prishtinë : Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", 2022. – 370 f. : ilustr. ; 24 cm.

Mjekësia -- Anatomia e njeriut -- Trupi i njeriut

1.Çerkezi, Selim 2. Shatri, Jeton

ISBN 978-9951-00-324-7

Ky tekst është lejuar për botim dhe përdorim për nevoja universitare me vendim të Këshillit Botues të UP-së dhe për të recensentët kanë konstatuar se paraqet vlerë të shtuar në literaturën përkatëse në gjuhën shqipe. Fjala është për një tekst universitar akademik autentik, modern, me kontribut të identifikueshëm në fushën e anatomisë dhe që shquhet për paraqitjen skematike dhe të thjeshtëzuar të problemeve të ndërlikuara.




JAHA-ISMAILI, VLORA

Diarrea rotavirusi infeksioni/Vlora Ismaili- Jaha. - Prishtinë:
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2023. - 86 f. : ilustr. ; 24 cm.

Mjekësia -- Epidemiologjia -- Diarrea
Zorrët -- Sëmundjet -- Tekste universitare
ISBN 978-9951-00-326-1

Ky tekst është lejuar për botim dhe përdorim universitar me vendim të Këshillit Botues të UP-së si tekst që sjell për profesionistët e fushës përkatëse një studim të përkushtuar afro njëzetvjeçar të autores për këtë patologji. Teksti ofron për studentët dhe profesionistët e mjekësisë klinike dhe paraklinike të dhëna autentike vendore dhe qëndrimet e trupave autoritativë ndërkombëtarë rreth kësaj sëmundjeje.



MONOGRAFIA: 50 vjetori i Fakultetit të Mjekësisë /

kontribues Katedrat e Fakultetit të Mjekësisë. - Prishtinë:

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2022. - 383 f. : ilustr. ; 24 cm.


Arsimi i lartë – Historia

Fakulteti i Mjekësisë – Biografi – 1969 – Prishtinë (Kosovë)

ISBN 978-9951-00-318-6

Kjo monografi është lejuar të botohet si tekst i Universitetit të Prishtinës me vendim të Këshillit Botues të UP-së në shenjë nderimi për kontributin e gjeneratave të tëra të përkushtuara në ndërtimin dhe avancimin e njëres prej njësive akademike më të shquara, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon: Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës.

Me kontributin e të gjitha katedrave të Fakultetit të Mjekësisë, në këtë tekst janë pasqyruar, përveç historikut, të dhënave për stafin, programet mësimore, infrastrukturës edhe arritjet shkencore, përsosja postdiplomike e stafit, publikimet shkencore, tekstet universitare, bashkëpunimi me institucionet simotra me renome ndërkombëtare. Kjo monografi do të shërbejë si informator i rëndësishëm për brezat, duke sjellë një histori të plotë të zhvillimit akademik të shkencave mjekësore në Kosovë.



GJONBALAJ, MUJË

Menaxhimi i projektit / Mujë Gjonbalaj. - Prishtinë:
Universiteti "Hasan Prishtina", 2023. - 373 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm.
ISBN 978-9951-00-330-8

Ky tekst është lejuar për botim dhe përdorim universitar me vendim të Këshillit Botues të UP-së dhe me këtë rast i është ofruar audiencës një tekst ekzemplar për një temë aktuale: menaxhimi i projekteve. Përmes një korpusi të madh informatash narrative, grafikëve dhe instrumentesh të tjera, të shtjelluara me profesionalizëm, recensentët vlerësojnë se autori me sukses të plotë prezanton çelësin e ndërlidhjes së elementit praktik me atë teorik të menaxhimit të projektit dhe na ofron një tekst, që edhe pse tipik shkencor universitar, do të jetë, pa dyshim, i dobishëm për një shtresë më të gjerë ekspertësh si nga fusha e ndërmarrësisë, institucioneve të ndryshme financiare apo edhe hartues të politikave publike.



UNIVERSITETI I PRISHTINË
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Adresa:

Rr. "George Bush", Nr. 31, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës

Tel:

+383 38 244 183/244 186

Email:

rektorati@uni-pr.edu